

LULJETA BORA-BEJLERI

ASPEKTE GJUHËSORE TË LIGJËRIMIT ARTISTIK NË PROZËN E  
TEODOR KEKOS (1958-2002)

Teodor Keko, njeriu, gazetari e shkrimtari, që nxitoi të përshkonte gjithë udhën e jetës së tij në 44 vjet, mbetet në letrat shqipe, për fat të keq, një botë artistike e gjuhësore e pastudiuar. Qëllimi i kësaj pune nuk ka të bëjë me vlerësimin e figurës dhe veprës në përgjithësi të shkrimtarit, por me analizën e ligjërimit artistik në veprat e tij, që mbetet një origjinalitet për regjistrin e prozës e poezisë shqiptare.

Për të analizuar veçoritë e ligjërimit artistik në drejtimin gjuhësor të veprës së autorit në fjalë na duhet më parë të themi dy fjalë për drejtimin artistik të cilit i përket proza e T. Kekos. Teodor Keko i përket drejtimit verist. Vëmendja ndaj personazheve marginalë mes apatisë së jetës e vuajtjeve për mbijetesë, përshkrimi me imtësi i karakteristikave dhe mendësive të individëve të një periudhe historike, trajtimi i temave të përditshmërisë, vëmendja ndaj personazheve marginalë zhytur në apatinë e jetës dhe vuajtjeve për ekzistencë, ligjërimi i përditshmërisë ngopur me frazeologji, krahinorizma, e përdorime të gabuara, janë specifika që e karakterizojnë artin e tij si Verist.

Por t'i kthehemi argumentit që do të trajtojmë duke renditur karakteristika gjuhësore të ligjërimit.

**1. Gjuha bisedore**

Gjuha e personazheve të Kekos është gjithmonë **ajo bisedore**. Ky autor, mbetet mjeshtër në shfrytëzimin e ligjërimit të përditshmërisë, ashtu sikurse edhe në ligjërimin zhargonor<sup>1</sup>. Zgjedhja e mënyrës së ligjërimit dhe veçanërisht një fondi të caktuar fjalësh, përbën një nga veçoritë e spikatura të origjinalitetit të Kekos, arti i të cilit na kujton thënien e G. Leopardit *stili është një lloj mënyre, ose force që quhet origjinalitet* dhe forca e origjinalitetit të Teodorit qëndron edhe tek bashkimi i gjuhës së përditshme me atë artistike, ngritjen e frazave spontane të rrjedhshme të të folurit të përditshëm në planin e

---

<sup>1</sup> *Fjalor shpjegues i termave letrare*, Tiranë, 1972, f. 152, ZHARGON (fr. jargon) – të folur popullor, të folur origjinal, konvencional, grumbull fjalësh dhe shprehjesh të veçanta të cilat i përdor ndonjë grup shoqëror, apo rreth njerëzish (zhargon i muratorëve, i vjedhësve, i aristokracisë, i shtresave të larta të borgjezisë ku hyjnë fjalë që shprehin gustot e tyre të veçanta si dhe mënyrën e shprehjes së stërholluar. Zhargoni e bastardon gjuhën, përdorimi i tij në vepër artistike-letrare është i justifikuar vetëm në raste kur ai është i domosdoshëm për të dhënë karakteristikën e të folurit të personazhit.

ligjërimit artistik, një trazim i thjeshtëzuar i gjuhës bisedore me mjete të letrares.

... si një qiell që i shkarkon me zhurmë e poterë të gjitha shirat e mbledhur brenda tij”, i shtangur si trung i sharruar në rrëzë (f. 80), llokume mizerabël si mastiç (f. 88), i thërrmoi fjalët (f. 80), vit i humbur nga balli i jetës sime (f. 80)

Në ligjërimin e aktantëve, ku dominon marrëdhënia vetjake e ligjëruesit me bashkëbiseduesin, efekte evokuese të shumta përcillen mes përdorimit të trajtave arkaike të krahinorizmave të Tiranës. Forma të shtrembëruara, të vjetruara që tregojnë një shkallë të ulët të kulturës së aktantit, apo forma të cilat sapo janë krijuar dhe janë pasqyrë (siç e pohon autori në një intervistë) e të folurit të viteve ’80 hasen rëndom në gjithë prozën e Kekos. **Ato sjellin konotacione të caktuara, më së shumti ironinë e humorit të zi** të Kekos, ashtu sikurse përmendja e toponimisë së Tiranës mes nëntekstit,

a) ...pse ka shpirt qeni **mër** babë, e pati pyetur Koli dhe i ati ia kishte kthyer gjithë aq butësisht se shpirt ka edhe kaurri **mër** bir, e jo më qeni...<sup>2</sup>

b) Flet sikur Shqipëria është e mbushur **tumllas** me vejusha<sup>3</sup>

c) ...do thonin njerëzia se ai s’kishte **makar** një këmishë<sup>4</sup>

d) ...si nuk harroi asnjë mallkim **mërbahu**?!<sup>5</sup>

**Përdorimin e pasthirmave e mallkimeve**, që vijnë rëndom në ligjërimin e përditshëm dhe që gjenden me shumicë trazuar letrarisht me ironinë tek lënda letrare e Kekos, kanë qenë pjesë e jetës individuale të autorit dhe na kujtojnë oratoritë e tij simpatike të Parlamentit.

Ti s’kishe as biletë urbani, or qyq., Theftë zverkun, O zot na ruaj, Ia dëgjova, për atë bukë (zërin), paçka se ..., Bela, tani kjo do na nxjerrë bojën posht e lart, Më rrofsh o djalë, ...përmedemek unë vi për t’u tallur, Do dhe të martohesh, le pa le!...më hëngërt kolera që nuk i përzieva edhe ca gurët mirëpo sa para bën.. etj. etj. (“Lajmëtarja e vdekjeve”)

Intonacioni thirrmos zë një vend të veçantë tek prozat dhe shpreh zakonisht gjendje të tilla si kulminacione mërzitje, apo trishtimi.

## 2. Epitetet e hiperbolizuara dhe përshkrimet

Situatat e humorit janë të shumta tek lënda letrare e Kekos. Në to spikasin karakterizime me doza hiperbolizimi, mes mbiemrave kompozita, si ato që tipizojnë Bertin *kockëmadh me një alamet hunde gjysmëkilogramshe*, të cilat jo thjesht paraqesin një situatë humorit, por edhe shenjojnë mendësi e tipare të shqiptarit në periudhën e tranzicionit. Varianti ligjërimor i prozave, i shkon

<sup>2</sup> Teodor Keko, *Prostituta*, “Maluka”, Tiranë, 1996, f. 165.

<sup>3</sup> Po aty, f. 83.

<sup>4</sup> Teodor Keko, *Lajmëtarja e vdekjeve*, f. 4.

<sup>5</sup> Po aty, f. 268.

për shtat zbehtësisë së ngjyrave të realitetit që dhe mosdashjes së autorit për ta vështruar ndryshe.

Është një kohë **e poshtër** (ep). *Me një qiell pisanjos* (ep), **hi dynjaja** (met.hiperb), **që i mban shirat të rrasura nëpër sqetulla resh** (shpr.fraz) e **t'i flak kokës** (met) atëherë kur **të gënjen mendja** (shp.fraz) *se s'ka shi*. **Kohë mizerabël** (ep) për të katër ne, që po prehemi në parmakët e urës së madhe, ku kryqëzohen një tufë rrugësh me shetitoren e madhe të Tiranës. *Sot s'do të ketë xhiro me femra idiote që bëjnë sikur kanë dalë për ajër të pastër në shëtitore dhe shemben duke thithur* (fraz. me ngjyrë hiperbolizimi) me gjithë kapacitetin e mushkërive ajrin **kanceroz** (ep), **që iu falin** (met.foljor) kaldajat plot qymyr koks të ministrive. **Kohë e fëlliqur** (ep.metaforik) për Kol stomatologun, që një e dy gogësin për gjumë, idem për Tur hidraulikun, që nuhat si zagat ato studentet e hutuara të viteve të para e që gjysmën e ditës e kalon në fillim të sezoneve shkollore i ulur te bordurat e zyrës së adresave, e keqe për mua, studentin e vitit të fundit të degës për gjuhë –letërsi, **pa shprehje** (ep) për Gon ekonomistin, vjeshtuk i përhershëm.<sup>6</sup>

Nga vjelja shteruese e epiteteve në veprën “Lajmëtarja e vdekjeve”, rezultojnë 221 fjalë epitete. Ato janë kryesisht epitete mbiemra të formuar me prejardhje, me prapashtesim, ku dominon prapashtesat fjalëformuese: **-shëm, -tar, -ës, -shme, -ar, -an, -të** dhe prapashtesat e tipit **-pa, -stër** (që janë shumë të paktë në numër në krahasim me fjalëformimin me prapashtesim), të cilat sjellin ngjyresa origjinale tek Keko në hullinë e tragjizmit të jetës dhe sidomos hiperbolizimit të anëve negative të saj, karakterit të personazheve dhe dukurive. Tipi i epitetit kompozitë (**pamjevagëlluar, shtrat çudibërës, shtrat fatprurës, zë zvargur, qejfmosprishës, dritëshkurtër, zë paqedashës**), është i pakët, ashtu si epitetet prejpjesorë (ishte **e hapur, me gjuhë tashmë të liru, më një vështrim të topitur**), ndërkohë që shumë pak nga epitetet e hasur janë të pamë.

E parë imtësisht në këtë aspekt, vepra me proza të shkurtra “Prostituta”, shfaq po këtë dukuri. Figura bosht aty bëhet femra. Mbiemrat karakterizues që mbushin lëndën letrare në këtë vepër janë **më së shumti në shkallën sipërore** (kryesisht absolute). Mbiemrat që karakterizojnë figurën e gruas problematike janë shumë. Ata janë kryesisht të nyjshëm, pak kompozita dhe më shumë të prejardhur. Shumë nga veprimet e femrave prostituta janë pjellë e çastit kalimtar, dhe vështirë se ruhen të gjitha në kujtesën e lexuesit, por pikërisht tek ky spontanitet Keko ndriçon një anë të së bukurës së tyre duke i qemtuar këto çaste dhe duke i përcaktuar këto figura pozitivisht mes mbiemrave: **erëmirë, tmerrësisht e bukur dhe e rraskapitur, tmerrësisht e bukur dhe e trishtuar, tmerrësisht e vetmuar dhe e humbur, cipëhollë, e lakuar, e**

<sup>6</sup> Teodor Keko, *Lajmëtarja e vdekjeve*, tregimi “Ne”, Naim Frashëri, Tiranë, 1991, f. 187.

***hijshe sikur vjen nga derë e mirë, llahtarisht e bukur, e sinqertë tragjikisht, truphajtshme,...*** etj. etj.

Mendojmë se Keko është i dashuruar veçanërisht me këtë figurë të personazheve të tij marginalë.

### 3. Frazologjitë

I foluri i zhërvjellët i personazheve është i mbushur natyrshëm me frazeologji dhe përdorime të shkallëve sipërore të ndajfoljeve (*jashtëzakonisht, llahtarisht, shumë, tejet, tmerrësisht, fare, skajshëm* etj.), që përkufizojnë botën shqiptare, dëshirat, mungesat dhe përpjekjet shpesh satanike për të mbijetuar: *Në hava e për laraska pat fluturuar, S'i hyn në xhep askujt, Kalova lumin pa u lagur, Ajo notonte në këto ujëra, u bë qiqër, ishte lëng groshe, fjala ka marr dhenë, i doli në shteg, ka hall koke, i luan tepeleku*, etj., etj. pa fund frazeologji të gjuhës së përditshme të shqiptarëve në jetën e tyre të thjeshtë

### 4. Përfundimet filozofike alla-Keko

Sendërtimi zhargonor i rrëfimit dhe dialogut fiton shprehësi dhe kulmohet kur jepet në tipe konkluzione filozofike (të rrëfyesit dhe personazheve) ndonëse të thjeshta fare në dukje. Duhet thënë se Keko e ka prirje **përfundimin me vlerë filozofike**, apo ndonjë rikujtim proverbial në fundet e prozave si p.sh.: *Edhe vekja sillka lumturi e prehje* ("Lajmëtarja e vdekjeve", f. 75), *Po e njohe njeriun, do ta urresh* (f. 96), *Mërzia kapërdihet kur nuk shoqërohet nga dhimbja e kokës* (f. 96), *Vdekja nuk është mizore kur ke jetuar, por është për të vënë kujën kur ikën sikur s'ke qenë në këtë botë* (f. 83), *Njeriu siç ha bukën edhe gabon, po kështu duhet falur* (f. 252), *Kur bashkohet eksperiencia me axhamillëkun ndodhin katastrofa*, etj., etj.

Ka edhe raste kur Keko me mjeshtëri ndërfit në një sentencë popullore, fjalë nga fondi i thjeshtligjërimit, duke e bërë përdorimin e saj origjinalitet të vetin si në rastin: *halle –halle kjo hale dynja* / sipas modelit popullor – "*halle-halle kjo dynja*"

### 5. Antonimia në ligjërimin subjektiv

Ligjërimi subjektiv, e funksional, shfrytëzohet gjerësisht nga Keko tek prozat, për të sendërtuar një realitet artistik pasqyrues të boshllëkut shpirtëror që krijon jeta e varfër e monotone e personazheve. Ligjërimi subjektiv, veçanërisht bukur vjen në prozat që kanë bosht figurën e prostitutës. Keko përpiket të ndërtojë një purgator artistik ku t'i vendosë personazhet e dashur. I ndriçon me aureole hyjnore, i vë emra shenjtoresh, i sheh me sy dashamirës, ndërton zhargonin e tyre dhe idiolektin e gjithsecilës në mënyrë kaq të veçantë sa edhe pse janë pjesë e të njëjtit brumë njerëzor në asnjë moment nuk e përsërisin njëra-tjetrën

*...Edhe një kokërr leku s'e kapëm, edhe ç'kishim na i rrubatën, edhe emri prostitutë na ngeli...*<sup>7</sup>

<sup>7</sup> Teodor Keko, *Prostituta*, "Maluka", Tiranë, 2006, f. 95.

**Antonimia** dhe në këtë vepër, është detaj i rëndësishëm që fillon që nga imazhi (prostitutë dhe shenjtoje), deri tek rastet e pranëvendosjes së fjalëve në raporte përjashtuese me njëra tjetrën apo, në rastet e antonimisë kontekstuale, për të cilën mendojmë se është zgjedhja artistike e Kekos, për të bërë bashkëpunues lexuesin në revoltën e tij artistike dhe në mendësinë e pranimit e shpëtimit të këtyre krijesave që kontrastojnë me shabllonin. Në këtë botë të gjithë janë nga pak **kurva**, ndërkohë që tregohen me gisht vetëm **Ato**.

**Prostituta** është me besnike se **kukulla** e familjes, (...) ky **engjëll** s'kishte asgjë të përbashkët me **kurvërinë**, me atë sëmundje që ishin përpjekur t'ia injektonin...

#### 6. Prania e trajtave të thjeshtligjërimit

Është fakt, se thjeshtligjërimi, i cili ka pjesë të tij edhe të folurin në zhargon që rrëshqet shumë herë mes banaliteteve, nuk është hasur në letrat shqipe. Nga fondi i thjeshtligjërimit Keko shfrytëzon kryesisht emërtime të turpshme të pjesëve të trupit njerëzor, apo fjalë që mbajnë nëntekste të turpshëm dhe së fundi sharje të turpshme. Ky fond banal gjendet kryesisht tek ligjërimit i aktantëve meshkuj, apo narratorit, kur ky është personazhi që rrëfen e përshkruan. Fjalë a shprehje banale të caktuara bëhen pjesë e përveçimit të figurave të caktuara (tutorit, të papunit, tipave të pa gdhendur, tipave "kazalog i zi" po të përdornim një kategorizim të Dorit, etj. etj.) dhe i vendosur në gojën e personazheve, **krijon një realitet të ri të fjalës, i cili ndikon në realitetin e lexuesit jo aq me kuptimin parësor sesa me ngjyresën.**

Prirja drejt të thjeshtave (në dukje), sjell si nevojë thjeshtëzimin e ligjërimit, i cili duket kaq i natyrshëm në përshtatje me dyzimet njerëzore të këtyre njerëzve të vegjël gjithë halle që janë nga pak Hamletë në monologun e përpjekjeve të tyre për të mbajtur jetën me thonj mes mëdyshjeve "Të rrosh, a të mos rrosh?" Intuita e të talentuarve e drejtoi këtë autor për nga një linjë ligjërimore që vërtitet rreth qerthullit të ligjërimit gazetaresk dhe atij bisedor me pak tharm letrar. a) *Vajazat filluan të qeshnin, kurse kamerieri u shtri si lopë në banak.*<sup>8</sup> b) *Kahu përpara.*<sup>9</sup> c) *Vetëm ai "sikurtish"-i nuk më linte ta shijoja plotësisht, sepse vërtet, sikurtish i gjallë ai djali i masakruar më keq nga Krishti, ajo do më harronte, dhe ajo më e tmerrshmja, ASGJË!*<sup>10</sup>

**Keko luan me fjalën e thjeshtë, luan edhe me përdorimin e saj të zakonshëm.** Në fragmentin mësipërm përdorimi "si lopë", krahasim i rëndomtë i figurave demode e të rëndomta femërore, bëhet në fakt drejt një karakteri mashkullor gjithashtu pjesë e të zakonshmëve të rëndomtë, duke theksuar situatën e humori. Ndërsa në shembullin tjetër emrin **kahu** (drejtim,

<sup>8</sup> Teodor Keko, *Curriculum vitae*, tregimi "Kafë Europa", Toena, Tiranë, 2008, f. 83.

<sup>9</sup> Teodor Keko, *Lajmëtarja e vdekjeve*, "N. Frashëri", Tiranë, 1990, f. 54.

<sup>10</sup> Po aty, f. 73-74.

me kahe të kundërta)<sup>11</sup>, e përdor në mënyrë vetjake si folje. Dhe në shembullin e tretë gjithashtu, gabon qëllimshëm shkrimin *sikur të ish*(te). Po në hullinë e këtij origjinaliteti, shohim se, tek lënda artistike e Kekos, hasen edhe përdorime të pa zakonta të epiteteve që bashkojnë fusha të ndryshme, apo që krijojnë antonimi të rralla si: *vdekjet e arta që më lumturuan...*<sup>12</sup>, *çudi e çuditshme*. (f. 47), *kumbull e gjymtuar*. (f. 111), *fusha me një jeshil të ngrohtë*. (f. 48)

Ndërkohë një grup fjalësh, ndonjë huazim i veçantë, apo konstruktesh të tipit togfjalësh që hasen si të rimarra nga proza në prozë, por edhe në poezi (ashtu sikurse personazhet) sjellin stilema të veçanta të kthyer në klishe tek arti i Kekos, **përftesat e të cilave janë pothuaj gjithmonë të natyrës përkeqësuese, denigruese.**

*Tavolinë e mallkuar, e qeshura e mallkuar, vetmia e mallkuar, dialogë perversë, psherëtimë banale, kohë e fëlliqur, kohë e ndyrë, kohë e poshtër, kohë pa shprehje, trishtim i poshtër, mërzi e poshtër, iku trishtaman, pis gojë, pis karakter, rropatje homerike, gabim homerik, karakter mizerabël, kohë mizerabël, zemër mizerabël, zemër mizerje, një mizerabël mërzi, ferr heshtaman, iku heshtaman, shi heshtaman, i mjerë, hollak, i shpartalluar, etj. etj.* ashtu sikurse një grup fjalësh që gjenden të përdoruara rëndom (prozë-poezi): *shi, baltë, erë, tokë, shpezë, natë, varr, re*, që shërbejnë si një kod për t'u ndërfutur në artin fatalist, të Dori Kekos.

### 7. Krijues i fjalëve të reja

Tek T. Keko haset përpjekja për të krijuar **fjalë të reja**, por interesante është se ky fjalëformim kryhet po mbi një bazë zhargonore. Keko qëmton fjalët e prapashtesat, në ndonjë rast devijon qëllimshëm prapashtesat e natyrshme të fjalëformimit të shqipes për sjellë mes fjalëve konotacione origjinale, nëntekste të boshllëkut e mungesave materiale e shpirtërore të personazheve e të një shoqërie të tërë të ngritur mbi sllogane.

Fjalët e krijuara janë kryesisht mbiemra e më rrallë emra e ndajfolje. Nga vjelja shteruese e veprës me proza të shkurtra "Lajmëtarja e vdekjeve" rendisim këto fjalë të reja të Kekos.

1. (...) *lajm që ka ruajtur kobësinë* (f. 179) (emër) e formuar nga "kob"<sup>13</sup>

2. (...) bën çudi me *shpirtkazmërinë* (f. 180) e këtij biri nakar e ardhur nga mbiemri "shpirtkazmë"

3...dhe një vajzë arriti deri në përlotje e dënësje **hallqarëse** (f. 20) (mbiemër kompozitë)

<sup>11</sup> *Fjalor i gjuhës shqipe*, Akademia e Shkencave, Tiranë, 2006, f. 427.

<sup>12</sup> *Lajmëtarja e vdekjeve*, f. 93.

<sup>13</sup> Trajtat që gjenden në *Fjalor i gjuhës shqipe*, Akademia e Shkencave, 2006; kob, kob/zi, kob/zezë, i kobshëm, e kobshme, kobtar, f. 468.

4. Por ja, ato **brishtësia** (f. 24) (emër) e fjalë herë-herë të rreshtuara në një prozë të rëndomtë, u hodhën si urë.. (emër i prejardhur, që mes prapashtesës -ra, sjell konotacionin përkeqësues, ashtu sikurse në rastet të tjera kishte idera, **këta** bukuroshër

5. Iu afrua fotografisë si të bindej se atje ishte një qenie **e pangjallshme** (f. 30) (mbiemër) vetëm e fiksuar në celuloid. (mbiemër i prejardhur, formuar me parashtesë e prapashtesë)

6. **Ofshamës** (f. 35) (mbiemër) buzërrudhur, priti që ajo të dilte në skajin tjetër të telit. (mbiemër i ardhur nga folja ofshaj)

7. I ra lehtë në faqe kufomës që po **manushaqohej** (f. 60) folje ardhur nga emri manushaqe)

9. Mos e bëj pis dashurinë, atë send **vitrinazhi!** (f. 75) (em) (emër ardhur nga emri vitrinë)

10.(...) por ajo më nëpërkëmbi **fodullisht** (f. 75) (ndajf) ndoshta e neveritur edhe nga fakti që unë isha ende i gjallë.- ma zuri fjalën në fyt krejt **fodullshe** (f. 76) (ndajf) ajo dhe krisi e doli nga ëndrra. (ndajfolje të ardhura nga mbiemri fodull)

11....u zhvesha e rash në shtrat gjoja **suprizshëm** (f. 79) (ndajf), por në të vërtetë i liruar nga teshat. (ndajfolje e ardhur nga emri surprizë)

12. Kështu kishte qenë gjithmonë kjo Idë, teorike, tip **mitingash** (f. 81) kazan plehrash i mbushur me deklarata (...). (emër rrjedh. i ardhur nga emri miting)

13. Aty nga fundi i shtatorit, një pasdite **zagushitëse** (f. 90) me një jugë mbytëse në rrugët e pluhurosura, kuiti përvojshëm telefoni.(mbiemër i ardhur nga emri zagushi)

14. ...ajo e qeshura e saj e paprangueshme, **lozonjariteti** (f. 90) dhe koketëria njëjerësh. (emër i ardhur nga mbiemri i/e lozonjar(e))

15. Unë jam shumë i vrarë shpirtërisht- i thashë- **jashtëzakonishtëmënisht** (f. 99) i mërzitur (ndajfolje e ardhur nga ndajfolja jashtëzakonisht)

16. Ç'po bën vaki, **shenjëronin** (f. 123) ata me njëri-tjetrin, ama gojën nuk e hapi kush... (folje e ardhur nga emri shenjë, në kuptimin bënin shenja me njëri-tjetrin)

17. ...e këshillonte ëmbëlsisht Vangjeli **pamjelumtur** (f. 168) (mbiemër kompozitë)

18. ...ndërkohë që përbri një fqinj i së ndjerës, bën çudi me **shpirtkazmërinë** (f. 180) (emër)e këtij biri kanakar.( emër i ardhur nga mbiemri shpirtkazmë)

19. **Qejfmosprishës** (f. 204) Berti i saj i rënë nga qielli e që e ëma falte pasurinë ta shihte të varur në ndonjë çengel kasapi, (...) mbiemër kompozitë.

20. (...) Qan nga lumturia - i buzëqesh **kolmësirës**. (f. 228), (emër ku shfrytëzohet mbiemri "i/e kolm/ë )

21. *Po unë pse kam lindur, e pyeta veten dhe kaq u desh të hyja në pikëllusat (emër) e pashërueshëm më. (shfrytëzohen trajtat pikëllim, pikëllor, i/e pikëlluar)*

Siç shihet, në fjalëformimet e tij (emër, mbiemër, ndajfolje e rrallë folje) dominantë janë ato të tipit me prejardhje dhe më pak kompozita. Prapashtesat i japin dorë autorit të sjellë konotacione të caktuara.

Letërsia që bëri Keko është fataliste, prandaj trishtimi dhe humori i zi me ngjyra të hiperbolizimit, është dominant në të. Disa nga neologjizmat stilistike të Kekos shmangen nga tipet e fjalëformimit. Në ndajfoljen më poshtë, fjalë e krijuar prej tij sipas modelit me prejardhje, qëllimi artistik i formimit është i dukshëm.

Shkalla e mbiemrit më poshtë është gjithashtu një neologjizëm jo i zakonshëm.

**Jashtëzakonishtëmënisht** i mërzhitur. Siç shihet pjesë interesante e stilit të Kekos, është krijimi i ndonjë fjale (apo përpunimi), që në fakt del një shmangie e qëllimshme e normës për të sjellë përfatesë të caktuara.

**Në përfundim:** Në letrat shqipe, Teodor Keko mund të përcaktohet si autori i dashuruar me gjuhën e rrugës, pikërisht ai shkrimtar që ndërton vetëdijshëm një ligjërim të ri mbi hijeshinë e gjuhës bisedore, zhargonit e thjeshtëligjërimin. Larmia e konstrukteve gjuhësore, tejngopja me frazeologji, fjalët e reja që autori krijon dhe vë në gojën e aktantëve, e bëjnë artin e autorit mjaft popullor.

#### BIBLIOGRAFI

- Agron Tufa, *Letërsia dhe procesi letrar në shekullin XX 1*, "Shblu", Tiranë, 2000.  
 Elda Tuka, *Traditë dhe risi në poetikën veriste italiane*, "Rama Graf", Elbasan, 2011.  
*Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006.  
 Gjovalin Shkurtaj, *Sociolinguistika*, "SHBLU", Tiranë, 2003.  
 Jani Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1984.  
 Luljeta Bora-Bejleri, *Monografi për krijimtarinë e Teodor Kekos*, "Neraida", Tiranë, 2011.  
 Mehmet Çeliku, *Përbërësit sinaksorë, Sintaksa e gjuhës shqipe në një vështrim të ri teorik*, 2011.  
 Teodor Keko, *Curriculum Vitae*, Tregime të zgjedhura, "Toena", Tiranë, 2008.  
 Teodor Keko, *Dymbëdhjetë shenjtorë një profet dhe disa njerëz*, "Maluka", Tiranë, 2006.  
 Teodor Keko, *Lajmëtarja e vdekjeve*, "Naim Frashëri", Tiranë, 1991.  
 Teodor Keko, *Made in Albania*, "Albin", Tiranë, 1998.  
 Teodor Keko, *Prostituta*, "Maluka", Tiranë, 2006.  
 Xhevat Lloshi, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, "Albas", Tiranë, 2005.